

AKT- THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“RELENTLESS AA22” shpk

Ne Tirane, sot me datë 01/09/2022

Z. Marcello Subashi, i datelindjes 23/08/1992, ne Gjermani, shtetas/e Shqiptar/e, me banim ne Durres, lagjen 3 identifikuar me leternjoftim nr : 038042434 me karte identiteti me numër personal J20823071A madhore, me zotesi juridike për të vepruar.

Z. Vinçens Elezi, i datelindjes 28/11/1988 ne Durres, shtetas/e Shqiptar/e, me banim ne Durres, lagjen 3, me leternjoftim nr : 036363555 dhe numer personal: I81128069W madhore, me zotesi juridike për të vepruar.

Te cilet me cilesine e “Ortakeve themelues” kerkuan redaktimin e ketij akti themelimi, nepermjet te cilit deklaruan se me vullnet te lire te plote e te singerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “Per tregetaret dhe shoqerite tregetare”, ligjin nr.9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, ne ate Doganor, Fiskale Tatimor, rane dakorte te themelojne shoqerine tregetare, me pergjegjesi te kufizuar, “RELENTLESS AA22” shpk.

KREU I

Neni 1

Krijimi



“RELENTLESS AA22” shpk

Eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).Emertim i shoqerise do te jete I stampuar dhe ne vulen e saj.

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne QKB, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj, Shoqeria “RELENTLESS AA22” shpk, Pasi te kete fituar



personalitetin juridik, eshte pergjegjese ndaj te tretëve detyrimet dhe demet e shkaktuara gjate veprimtarise se saj, për të cilat përgjigjet brënda kufijve të përcaktuar në Ligjin 9901 datë 14.04.2008 si dhe akte të tjera ligjore.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka seline ne: Rr "Dritan Hoxha", Pallatet Komfort Përball Pallatit të Sportit "Asllan Rusi", Tirana 1001 Kati 0. Shoqëria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filial, si brenda ashtu edhe jashte Republikës se Shqipërisë. Shoqëria mund te ndryshoje seline e saj sipas vullnetit te Asamblese se Ortakeve.



Neni 4

Objekti i veprimtarise

Te ofroje një linje telefonike ndihme shumëgjuhëshe për klientin dhe shërbim suporti për çdo aktivitet dhe shërbim, te ofrojë shërbime tregtare dhe aktivitete mbështetëse. Te kryeje te gjitha veprimtaritë tregtare dhe zbatoje çdo mase për promovimin e drejtpërdrejtë ose te tërthorte te objektit te sipërpërmendur. Ne mënyre qe te përmbushë objektin e mësipërm, Shoqëria ka te drejte : Te lidhe çdo lloj kontrate apo marrëveshje me persona fizike ose me ente private apo publike, shoqëri, qeverinë dhe organizata te huaja ose shqiptare;

Te themeloje shoqëri te çdo lloji ose te behet pjese shoqërive shqiptare ose te huaja, ndërmarrjeve te përbashkëta ose lloje te ndryshme biznesesh me objekt te njëjte ose te ngjashëm;

Te themeloje dege apo agjenci ne Shqipëri ose jashtë saj; Te përfaqësoje biznese shqiptare ose te huaja te lidhura me objektin e Shoqërisë; Te marre ose japë hua, te pranoje garanci personale ose garanci te tjera, te marre përsipër detyrime, te lëshojë kambiale, urdhërpagesa, ceqe ose obligacione ose garanci ose tituj dhe te emetoje garanci te tjera financiare; Te ndërmarrë çdo veprimtari tjetër tjetër ligjor ose transaksion qe lidhet direkt ose indirekt me objektin e Shoqërisë ose qe synon ne mënyre te drejtpërdrejte apo te tërthorte përmbushjen e objektit te Shoqërisë. Shoqëria mund te kryeje ne mënyrë dytësore, pra rastësore dhe jo te drejtpërdrejtë, me qellim përmbushjen e objektit te Shoqërisë. Shoqëria sipas nevojave të aktivitetit ka të drejtën e ushtrimit të çdo aktiviteti të ligjshëm, të lejueshëm për formën e shoqërisë, e cila nuk ndalohet me ligj (sipas nenit 7 të Ligjit nr.9901,dt.14.04.08).



Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

KREU II

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 1.000.000 (një milion leke) leke, i ndare në 2 kuota.

Kapitali themeltar i shoqërisë, është kontribut i 2 (dy) Ortakeve të shoqërisë, me kuota si më poshtë:

1. Ortaku themelues **Marcello Subashi** zotëruesi i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 800.000 (tetëqind mijë) leke në para që përben edhe 80% të kapitalit themelues të shoqërisë ,
2. Ortaku themelues **Vinçens Elezi** zotëruesi i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 200.000 (dyqind mijë) leke në para që përben edhe 20% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të perfaqesohen nga letra me vlerë të tregetueshme. Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme të paluajtshme apo të drejta). Ortaket vetëm përgjigjet për humbjet e shoqërisë kundërsht të treteve deri në vlerën e kontributit të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Asambleja e ortakeve mund të vendosë që zmadhimi i kapitalit të kryhet me emetimin e aksioneve të reja, për t'u nënshkruar vetëm nga aksionarët ekzistues.



2. Zmadhimi i kufizuar i kapitalit mund të kryhet vetëm me miratimin unanimit të të gjithë ortakeve

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortaketve, e cila merr vendimin në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket në të njëjtin masë ndaj pjesëve të kapitalit që perfaqesojnë.

Neni 7

Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:



a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;

b) shitblerjes;

c) trashëgimisë;

ç) dhurimit;

d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

3. Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit, sipas pikës 2 të këtij neni.

4. Shoqëria regjistron kalimin e kuotës, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

KREU II

Neni 8

Organi Vendimmarres

Organet drejtuese te Shoqerise "RELENTLESS AA22" shpk jane:

1. Asmableja e Pergjitheshme.

2. Administratori I Pergjithshem I shoqerise do te jete Z. Soren Vrahoriti per nje periudhe 5(pese) vjecare.

Asmableja e Pergjitheshme është përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;

b) ndryshimet e statutit;

c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;

ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;

dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;


f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.



Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9

Administrimi

Administrator i shoqërisë “RELENTLESS AA22” shpk, caktohet, Z. Soren Vrahoriti i datelindjes 21/06/1991 ne Durres, dhe banues ne Lagjja.6, Rr”Shoqeria Bashkimi”, Nr.63 Durres, dhe numer leternjoftimi :036550759 personal: J10621068J i cili emerohet per nje afat 5 vjeçar me te drejte ripertritje.



Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakeve themelues te shoqërise.

Neni 10

Kompetencat

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;



dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

4. Në rastet e parashikuara nga pikat 3 e 5 të nenit 82 të këtij ligji, administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme.

5. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Statuti ose rregulloret e tjera, të miratuara nga asambleja e përgjithshme, mund të parashikojnë ndryshe.

6. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 11

Viti Financiar

Viti Financiar i shoqërisë fillon me 1 janar dhe perfundon në 31 dhjetor. Perjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB dhe mbyllet në 31 dhjetor.

Neni 12

Prishja e shoqërisë

Shkaqet e prishjes së shoqërisë Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;



b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;

c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi I veprimtarisë nëpërputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

d) me vendim të gjykatës;

dh) për arsye të tjera, të parashikuara në statut.



Neni 13

Baza ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e në ligjin 9901 datë 14.04.2008, "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare"(i ndryshuar)

Neni 14

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 kopje ne gjuhen shqipe, me permbajtje dhe vlera te njejta juridike.

Akti i mesiperm pasi miratohet në parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te shoqerise tregtare "RELENTLESS AA22"Shpk, nenshkruhet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin , mbiemrin dhe firmen e tij origjinale.

ORTAKET

E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

RELENTLESS AA22 sh.p.k

Marcello Subashi

Marcello Subashi

Vinçens Elezi

Vinçens Elezi

